

*Strategjia*  
E KOMUNËS SË  
JEGUNOVÇIT PËR  
BASHKËPUNIM ME  
SEKTORIN CIVIL  
DHE ZHVILLIMI I  
TIJ I PËRHERSHËM

2012-2015



KOMUNA  
JEGUNOVÇIT



# Strategjia

## E KOMUNES SË JEGUËNOVCIT PËR BASHKËPUNIM ME SEKTORIN CIVIL DHE ZHVILLIMI I TIJ I PËRHERSHËM 2012-2015

Dialogu qytetar në nivel lokal  
Projekti është i financuar nga Unioni Evropian

“Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Unionit Evropian.”



Q E N D R A  
M A Q E D O N A S E  
P E R B A S H K Ë P U N I M  
N D È R K O M B È T A R

Projektin e realizon Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar



# Përmbajtja

## I HYRJE

1.1. Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë .....	2
1.2. Metodologjia .....	3
1.3. Parimet .....	4

## II SEKTORI CIVIL NË JEGUNOVÇ 6

## III QËLLIMET SPECIFIKE 8

3.1. Vendosja e mekanizmit për bashkëpunim dhe sigurimi i informimit transparent mes komunës dhe organizatave qytetare .....	9
3.2. Krijimi i rrethinës mundësuese për nxitjen dhe zhvillimin e shoqërisë civile në Komunën e Jegunovçit.....	11
3.3. Inkuadrimi aktiv i qytetarëve dhe organizatave qytetare në proceset e krijimit të politikave lokale.....	12
3.4. Kontribut drejt qëndrueshmërisë financiare të sektorit civil dhe vendosja e partneriteteve mes organizatave dhe komunës .....	13
3.5. Pëmirësimi i kapaciteteve të administratës komunale dhe organizatave qytetare.....	14

## IV ZBATIMI, PËRCJELLJA DHE REVIZIONI 16

## Shtojca 1. Plani aksionar 18

I HYRJE

Krijimi i mekanizmeve institucionale për bashkëpunim të qytetarëve dhe organeve dhe trupave shtetërore, veçanërisht në nivel lokal në procesin e krijimit të politikave dhe akteve tjera është bazë e demokracisë participative. Inkuadrimi në krijimin e politikave lokale në mjediset rurale, siç është Komuna e Jegunovcit, gjithashtu nënkupton edhe mobilizimin e gjithë opinionit dhe të krijimit të kushteve për shprehjen e mendimit personal, jo vetëm në mënyrë të organizuar përmes organizatave qytetare, por edhe drejtpërdrejt nga ana e qytetarëve. Prandaj, Komuna e Jegunovcit në tërësi e njëj rëndësinë dhe rolin edhe të sektorit civil në zhvillimin e proceseve demokratike në komunë dhe në përgjithësi në zhvillimin dhe përmirësimin e jetës në bashkësi, por gjithashtu me këtë strategji do të krijohen kushte që të dëgjohen mendimet dhe propozimet e qytetarëve. Nga ana e vet sektori civil në Komunën e Jegunovcit edhe pse nuk është i zhvilluar sa duhet, megjithatë në periudhën e kaluar në fusha të caktuara kryen funksione të rëndësishme shoqërore. Ndikimi më i madh është kryer në fushën e barazisë gjinore dhe edukimin e gruas nga mjediset rurale, si dhe organizata që bëjnë promovimin e kulturës, i mbështetin të rinjtë dhe sportin.

Duke u nisur nga këto fakte, Komuna e Jegunovcit vendosi ta nxisë aktivizmin qytetar në komunë, ta avancojë bashkëpunimin me organizatat qytetare dhe të kontribuojë drejt zhvillimit të tyre të përhershëm. Ky dokument strategjik dhe aktivitetet e parapara nëa të do të paraqesin kornizë udhëheqëse për politikën e komunës drejt sektorit civil dhe drejt nxitjes së qytetarëve të inkuadrohen në krijimin e politikave lokale. Miratimi i Strategjisë së Komunës së Jegunovcit për bashkëpunim me sektorin civil dhe zhvillimin e tij të përhershëm është kontribut i drejtpërdrejt edhe drejt realizimit të njëres nga përpjekjet strategjike të përcaktuara në Strategjinë e Qeverisë për bashkëpunim me sektorin civil (2007-2011). Në të vërtetë, në qëllimin e shtatë të strategjisë nacionale është paraparë *“Përmes promovimit të qëllimeve dhe masave të strategjisë në nivel lokal, njësitë e vetëqeverisjes lokale do ta njohin rëndësinë e bashkëpunimit dhe zhvillimi të organizatave qytetare lokale dhe do të mund të miratojnë mekanizma të ngjashme për bashkëpunim dhe inkuadrim të organizatave qytetare në zbatimin e aktiviteve të përbashkëta”*.

Procesi i përgatitjes së strategjisë është udhëhequr nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) si pjesë nga projekti “Dialogu qytetar në nivel lokal), i zbatuar nga MCMS, ndërsa i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut (EIDHR).

Strategjia është miratuar më 29 dhjetor, në mbledhjen e 34 të Këshillit të Komunës së Jegunovcit.

# 1.1. Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë

Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është avancimi i bashkësisë përmes zhvillimit të sektorit civil dhe vendosjen e bashkëpunimit të përbashkët të organizatave qytetare me komunën.

Me implementimin e këtij dokumenti strategjik do të sigurohen mekanizma institucionale për bashkëpunim të komunës me sektorin civil, si dhe për nxitjen e zhvillimit të shoqërisë civile në nivel lokal. Bashkëpunimi do të orientohet drejt caktimit të përbashkët të prioritetëve dhe krijimit të politikave lokale, që do të sigurojë legjitimitet dhe mbështetje nga opinioni më i gjerë në komunë. Përmes krijimit të qytetarizimit aktiv do të mobilizohet opinioni i përgjithshëm në drejtim të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së bashkësisë lokale në pajtim me nevojat e qytetarëve.

Komuna do të angazhohet drejt krijimit të kushteve për vendosjen e bashkëpunimit institucional me sektorin civil dhe krijimin partneriteteve të qëndrueshme për:

- ▶ Përcaktimin e modelit institucional për bashkëpunim të vendosur dhe funksional mes komunës, organizatave qytetare dhe qytetarëve, si dhe transparencë në informimin e ndërsjellë;
- ▶ Mbështetje dhe promovim të nevojës nga veprimi i organizuar dhe shoqërimi i qytetarëve në interes të nevojave të bashkësisë lokale, gjegjësisht vendosjen e organizatave qytetare dhe forcimin e tyre për aftësimin e mëtejshëm aktiv të bashkësisë;
- ▶ Krijimin e politikave lokale dhe përcaktimin e prioritetëve me inkuadrim të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe organizatave qytetare;
- ▶ Qëndrueshmëria financiare e organizatave qytetare dhe bashkëpunimi në sigurimin e resurseve dhe mjeteve për realizimin e iniciativave zhvillimore;
- ▶ Forcimi i kapaciteteve të administratës lokale për zhvillimin e mekanizmave dhe formave të bashkëpunimit, si dhe forcimi i kapacitetit të sektorit civil për realizimin e iniciativave dhe projekteve me interes për bashkësinë lokale.

Angazhimi kryesor i Komunës së Jegunovcit është përmes kësaj kornize strategjike ta nxisë aktivizimin qytetar në vendbanimet në komunë dhe ti mbështesë format e shoqërimit të qytetarëve në funksion të prosperitetit të gjithë bashkësisë dhe komunës.



# 1.2. Metodologjia

## 1.2.1. Procesi i përgatitjes

Strategjia është përgatitur në mënyrë konsultative me inkuadrimin e rëndësishëm të organizatave qytetare në periudhën prej shatori deri në nëntor të vitit 2011, në dy faza.

Së pari u formua grupi punues për përgatitjen e konceptit të Strategjisë. Si mbështetje për udhëheqjen e procesit ishte përfaqësuesi i MCMS-së, ndërsa grupin punues e përbëjnë katër anëtarë dhe atë: një përfaqësues i Këshillit të Komunës së Jegunovcit, një përfaqësues nga administrata komunale dhe dy përfaqësues nga organizatat qytetare. Grupi punues mbajti tre punëtori njëditore, në të cilat u vendos struktura e strategjisë dhe u përcaktuan qëllimi i përgjithshëm, qëllimet dhe propozim-aktivitetet. Me propozim-konceptin e përgatitur u rumbullakua faza e parë nga përgatitja e strategjisë.

Propozim koncepti i Strategjisë u diskutua në forumin e parë me grup më të madh të organizatave dhe përfaqësuesve të Këshillit dhe të administratës komunale të Jegunovcit. Vërejtjet e dhëna në forum për dokumentin e propozuar përsëri u shqyrtuan nga ana e grupit punues. Plani i hollësishëm aksionar për herë të dytë përmes diskutimit në forum u diskutua me organizatat qytetare dhe me përfaqësuesit e Këshillit dhe të administratës komunale.

Krahas modelit të kombinuar në diskutime të fokusuar përmes grupit punues dhe konsultimeve të gjera, identifikimin e nevojave të sektorit dhe aktiviteteve prioritare gjithashtu u përcaktuan edhe përmes pyetësorëve të përgjigjur nga ana e organizatave.

Procesi i përgatitjes së Strategjisë u krye me punëtorinë konsultative dyditore të Këshillit programor të projektit “Dialogu qytetar në nivel lokal”, i cili u përpilua nga përfaqësuesit nga tre pilot komunat në projekt (Manastir, Dibër dhe Jegunovc), përfaqësuesit të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, përfaqësuesit të BNJVL dhe përfaqësuesve të MCMS.

## 1.2.2. Përfshirja e sektorit civil: grupi qëllimor

Grupi qëllimor ndaj të cilit në mënyrë primare kanë të bëjnë masat nga kjo strategji janë organizatat e regjistruara në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione<sup>1</sup>. Komuna e Jegunovcit ka mirëkuptim për përfshirjen e gjerë të shoqërisë civile, aktorët e të cilit janë edhe forma tjera të shoqërimit si: sindikatat, partitë politike, bashkësitë fetare, odat ekonomike etj., por u vendos që në këtë dokument për futjen në kornizë të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me shoqatat dhe fondacionet. Kjo strategji me titullin e vet dhe në përmbajtjen i përdor termet organizata qytetare, sektori civil, shoqëria civile të cilat referojnë në definicionin më të ngushtë dhe përdoren si sinonime për shoqata dhe fondacione.

<sup>1</sup> Gazeta zyrtare e RM, nr. 52/2010, Ligji për shoqata dhe fondacione

Nga ana e tjetër, opinioni i përgjithshëm gjegjësisht qytetarët nuk janë përjashtuar nga mundësia që ti shfrytëzojnë mekanizmat e inkuadrimin në krijimin e politikave në nivel lokal, veçanërisht që qëllimi me këtë dokument është të nxiten qytetarët që to njohin dobisht nga shoqërimi dhe veprimi i përbashkët për të mirën e përgjithshme të bashkësisë.

Bashkëpunimi me aktorët tjerë të shoqërisë civile edhe pse nuk është definuar qartë në strategjinë, e njëjta do të nxitet përmes aktiviteteve të përbashkëta të cilat do t'i ndërmerr komuna dhe organizatat qytetare.

### 1.2.3. Korniza kohore

Korniza kohore për zbatimin e strategjisë është katër vjet, dhe e njëjta do të zbatohet në periudhën nga janari 2012 deri në dhjetor të vitit 2015.

## 1.3. Parimet

### Partneriteti

Komuna e Jegunovcit dhe organizatat qytetare do ta ndërtojnë partneritetin e tyre duke u nisur nga nevojat dhe interesat e qytetarëve në komunë. Bashkëpunimi do të bazohet në bazat e njëjta mes të gjitha palëve me qëllim që të respektohen mendimet e ndryshme gjatë përcaktimit të qëllimeve të përbashkëta. Komplementarja në zbatimin e aktiviteteve do të respektohet nga të gjitha palët me qëllim që të dilet përballë me gjithë kapacitetin dhe diturinë.

### Mbështetja e ndërsjellë

Mbështetja e ndërsjellë veçanërisht është e rëndësishme për komunën për shkak të plotësimit të resurseve dhe kapaciteteve për zhvillimin e vet më dinamik. Përmirësimi i kualitetit të jetës mund të arrihet me veprimin e përbashkët më të koordinuar të gjitha palëve të interesuara. Organizatat qytetare dhe komuna përmes dialogut dhe konsensusit do ti inkorporojë vlerat dhe interesat e ndryshme në politikat lokale, që do të mbështeten nga ana e të gjithë qytetarëve të Komunës së Jegunovcit.

## Ndarja e përgjegjësi

Komuna dhe organizatat qytetare janë përgjegjëse në mënyrë të ndërsjellë para opinionit dhe qytetarëve në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta. Organizatat qytetare do të kenë përgjegjësi të plotë gjatë realizimit të aktiviteteve të mbështetura financiarisht nga komuna. Por, gjithashtu përgjegjësia do të jetë veçori e komunës në procesin e ndarjes transparente të mjeteve financiare ndaj organizatave.

## Transparenca dhe publikja në punë

Bashkëpunimi do të sigurohet me shkëmbimin e rregullt të informatave, zbatimin transparent të procedurave për financimin e projekteve të përbashkëta, si dhe sigurimi i qasjes së lirë të informatave të gjithë qytetarëve, që do të sigurojë inkuadrimin e tyre aktiv dhe kualitativ në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Dokumentet strategjike, planet dhe buxheti i komunës dhe të organizatave qytetare dot ë jenë të kapshme deri te opinioni. Transparenca dhe opinioni si parim në realizimin e bashkëpunimit do të mundësojë ndërtimin e besimit të ndërsjellë mes pushtetit lokal dhe qytetarëve.

## Mundësi të barabarta për të gjithë

Komuna do të angazhohet për respektimin e mundësive të barabarta dhe jo diskriminimit të gjithë njerëzve në procesin e praktikizmit dhe të drejtave dhe lirive të tyre themelore. Organizatat qytetare dhe komuna bashkërisht do të punojnë në promovimin e barazisë, inkuadrimin dhe sigurimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët. Me rëndësi të veçantë është respektimi i këtij parimi në proceset e zbatimit të Strategjisë duke pasur parasysh se sektori civil sipas natyrës së vet të veprimit i artikulon nevojat dhe interesat e grupeve të ndryshme qëllimore, veçanërisht ato të marginalizuara si: të varfrit, gratë, personat me handicap etj.

## Pavarësia

Organizatat qytetare janë të pavarura në realizimin e qëllimeve dhe prioriteteve personale të përcaktuara në dokumentet strategjike dhe programore. Gjatë vendosjes së partneriteteve Komuna e Jegunovcit do ta respektojë pavarësinë e qytetarëve dhe organizatave qytetare në proceset e konsultimeve, në realizimin e projekteve të përbashkëta. Dhe veçanërisht gjatë fitimit të mbështetjes financiare nga ana e komunës.

II SEKTORI  
CIVIL NË  
JEGUNOVÇ

Territori i Komunës së Jegunovcit gjendet në pjesën verilindore të Pollogut të Poshtëm, në anën perëndimore të malit gëlqeror Zheden dhe rrëzës jugore të Malit Sharr. Sipas lokacionit të vet ka rëndësi ekonomike për Maqedoninë Perëndimore, pasi që nëpër territorin e komunës kalon rruga rajonale Tetovë – vendkalimi kufitar Jazhincë - Ferizaj.

Komuna përfshinë sipërfaqe prej 174 km<sup>2</sup> ku janë vendosur 17 vendbanime. Në atë jetojnë 10.790 banorë. Vetë vendosja e këtij rajoni, mundëson zhvillim të bujqësisë, ndërsa një numër i vogël i popullatës merret me blegtori dhe ekonomi të pyjeve. Komuna e Jegunovcit ka burime të shumta të ujit natyror mineral, ndërsa masivi malor Zheden është i pasur me sasi të shumta gëlqerore – kalcium karbonit, dhe paraqet perspektivë të shkëlqyeshme për zhvillimin e rajonit.

Në administratën komunale për momentin janë punësuar 17 persona, ndërsa në punën e Këshillit të Komunës së Jegunovcit janë inkuadruar 15 këshilltarë.

Në pajtim me llogarinë përfundimtare të Komunës së Jegunovcit për vitin 2010 janë realizuar të ardhura në vlerë prej 105.559.763 denarë (janë planifikuar 121.196.001 denarë), derisa shpenzimet e përgjithshme të realizuara janë 98.247.807 denarë. Për mbështetjen e organizatave qytetare, Komuna e Jegunovcit nga buxheti i vet në vitin 2010 ka ndarë 310.000 denarë.

Në Komunën e Jegunovcit vepron numër i vogël i organizatave qytetare me pjesëmarrje të vogël qytetare. Në pajtim me të dhënat nga Regjistri qendror (RQM), në vitin 2010 ka pasur 28 organizata të regjistruara. Prej tyre deri në gjysmën e parë të vitit 2011 janë reregjistruar vetëm tre organizata qytetare. Edhe krahas numrit të vogël të organizatave qytetare, të gjitha nuk janë njëjloj aktive. Asnjë organizatë nuk ka personel të punësuar, dhe ekzistojnë vetëm me mbështetje të projekteve.

Pjesa më e madhe e organizatave nuk kanë kushte themelore për punë: nuk kanë zyra, nuk kanë persona të përhershëm të punësuar, mungon anëtarësimi aktiv. Duke pasur parasysh se bashkësia e donatorëve sa shkon është më e rreptë drejt mbështetjes së organizatave pa përvojë të mjaftueshme, Jegunovci ballafaqohet me sektor pasiv civil pa kapacitet për krijimin e projekteve të qëndrueshme, të cilat do të ndikojnë mbi zhvillimin e bashkësisë lokale.

Lidhur me fushat e veprimit të 28 organizatave të regjistruara, më me numër janë shoqatat sportive (11), pastaj tre veprojnë në fushën e kulturës, dy janë aktive në fushën socio-humanitare, ndërsa vetëm një vepron në pjesën e ekologjisë. Në fushat tjera të ndryshme veprojnë edhe 11 organizata tjera. Nga gjithsej 28 organizata në fund të vitit 2010 llogari përfundimtare kanë parashtruar nëntë organizata. Të ardhurat e përgjithshme të këtyre nëntë organizatave është shumë e vogël, gjegjësisht rreth 190,000 denarë.

Përpjekje për mbështetje të sektorit civil kishte para 10 viteve, kur në Komunën e Jegunovcit përmes bashkëpunimit të komunës dhe një organizate qytetare u formua OJQ qendra për mbështetje të sektorit civil. Por, pasi që nuk kishte qëndrueshmëri të siguruar financiare, OJQ qendra zgjati vetëm në periudhën sa kishte mjete të siguruar nga donatori. Në periudhën e kaluar përmes veprimit konkret më aktive ishin organizatat e grave dhe shoqatat kulturore-artistike nga komuna.

# III QËLLIMET SPECIFIKE

Komuna e Jegunovcit ka për qëllim ta zhvillojë bashkëpunimin me sektorin civil në funksion të avancimit të bashkësisë. Me Strategjinë do të intensifikohet bashkëpunimi me vendosjen e mekanizmave për bashkëpunim dhe sigurimin e kushteve për informim të vazhdueshëm mes komunave dhe organizatave qytetare.

Duke u përpjekur për këto arritje, Komuna e Jegunovcit kontribuon drejt forcimit të sektorit civil në drejtim të promovimit të rolit shoqëror që i takon sektorit. Gjithashtu komuna do të forcojë kapacitetet e veta që të mund të përgjigjet iniciativave dhe kërkesave të sektorit civil dhe të realizojë bashkëpunim cilësor me organizatat qytetare, me qëllim të veprimit të përbashkët për zhvillim të bashkësisë.

Arritjet e qëllimit të përgjithshëm të Strategjisë do të realizohet përmes pesë qëllimeve të lidhura mes veti:

- ▶ Vendosja e mekanizmit për bashkëpunim dhe sigurimi i rrjedhës transparente të informatave mes komunës dhe organizatave qytetare;
- ▶ Krijimi i rrethinës mundësuese për nxitjen dhe zhvillimin e shoqërisë civile në Komunën e Jegunovcit;
- ▶ Inkuadrimi aktiv i qytetarëve dhe organizatave qytetare në proceset e krijimit të politikave të autoriteteve lokale;
- ▶ Kontribut drejt qëndrueshmërisë financiare të sektorit civil dhe vendosjen e partneritetit mes organizatave qytetare dhe komunës;
- ▶ Rritja dhe forcimi i kapacitetit të administratës komunale dhe të OQ me qëllim të përmirësohet kualiteti i bashkëpunimit të ndërsjellë.

## 3.1. Vendosja e mekanizmit për bashkëpunim dhe sigurimi i informimit transparent mes komunës dhe organizatave qytetare

Komuna e Jegunovcit ka për qëllim ta nxitë inkuadrimin e sektorit civil në proceset e planifikimit, zbatimit dhe përcjelljen e politikave lokale. Komuna do t'i ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për krijimin e kushteve për komunikim të rregullt me sektorin civil dhe do të angazhohet për bashkëpunim të ndërsjellë, të qartë dhe të personalizuar. Baza e të dhënave në ueb faqen e Komunës së Jegunovcit do të sigurojë hapësirë për promovimin e sektorit civil dhe aktiviteteve përmes informimit të opinionit për ekzistimin e organizatave të regjistruara dhe aktive në komunë, si dhe informata tjera lidhur me fushën e tyre të veprimit. Ky qëllim do të arrihet përmes:

- 1) Caktimi i personit për bashkëpunim me sektorin civil me kompetenca të qarta të përcaktuara për punë;
- 2) Mbajtja e rregullt e mbledhjeve konsultative (koordinuese) mes komunës dhe sektorit civil;
- 3) Përcaktimi i një pjese të veçantë të ueb faqes për informimin e sektorit civil;
- 4) Vendosja e bazës gjithëpërfshirëse të dhënave të organizatave qytetare në komunë;
- 5) Mbështetja e formimit të Forumit të organizatave qytetare.

Për realizimin e këtyre rezultateve komuna do të caktojë nëpunës nga administrate e vet me angazhime themelore pune për bashkëpunim mes komunës dhe organizatave qytetare. Përshkrimi i obligimeve punuese do të përcaktohen në pajtim me nevojat për bashkëpunim dhe sistematizim organizativ në komunë. Do të vendosen rregulla për komunikim të rregullt mes bashkëpunëtorit përgjegjës dhe organizatave qytetare përmes mbledhjeve të rregullta, shkëmbimit të informatave, përgatitjes së buletineve informativ etj. Në mënyrë plotësuese do të vendosen raporte horizontale me nëpunësit tjerë në komunë, gjegjësisht do të vendoset komunikim i rregullt dhe raportim mes nëpunësit përgjegjës për bashkëpunim me OQ dhe nëpunësit tjerë, të cilët në punën e tyre përkohësisht realizojnë kontakte me organizatat qytetare ose kanë nevojë për inkuadrimin e tyre. Komuna do t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e kushteve teknike për informim transparent dhe në kohë për të gjitha politikat, të cilat përgatiten dhe miratohen nga ana e Këshillit, me mbajtjen e takimeve të rregullta me kryetarin e komunës dhe Këshillin dhe shërbimet e komunës me organizatat qytetare. Ueb faqja e komunës do të përmirësohet në funksion të komunikimit të rritur me organizatat qytetare. Në të vërtetë, do të sigurohet hapësirë në ueb faqen për të gjitha organizatat e interesuara, të cilat dëshirojnë të vendosin informata për aktivitetet e tyre. Komuna e Jegunovcit do të krijojë mundësi për krijimin e bazës të dhënave të organizatave qytetare në komunë dhe do t'i nxitë organizatat vazhdimisht ti azhurnojnë të dhënave tyre në këtë bazë. Ekzistimi i bazës në mënyrë plotësuese do të kontribuojë drejt përfshirjes së mekanizmit për bashkëpunim me organizatat qytetare. Komuna gjithashtu do të angazhohet për formimin e trupit të përhershëm koordinues të organizatave qytetare në komunë (p.sh. Forumi i organizatave qytetare), që parqet pikë e koordinimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, por njëkohësisht do të shërbejë edhe për dialog të strukturuar me komunën. Komuna do ta nxisë vendosjen e forumit dhe në fazën e tij iniciues përmes mbështetjes teknike dhe profesionale (proces konsultues për kompetencat, mbështetja në përgatitjen e dokumenteve themelore etj.), por gjithashtu kushtet themelore për funksionimin minimal të Forumit pas vendosjes së tij, gjithashtu do të sigurohen nga komuna.



## 3.2. Krijimi i rrethinës mundësuese për nxitjen dhe zhvillimin e shoqërisë civile në Komunën e Jegunovcit

Aktivizmi i vogël qytetar dhe numri i vogël i organizatave qytetare janë karakteristika të shumicës së komunave rurale, duke përfshirë edhe Jegunovcin. Prandaj komuna dot ë ndërmerr një sërë aktivitete me të cilat do t'i informojnë qytetarët për mundësitë për realizimin e interesave të tyre përmes organizimit në organizatat qytetare.

Kjo është në interes edhe të komunës, sepse në këtë mënyrë do ta lehtësojë edhe do ta intensifikojë komunikimin me qytetarët, me qëllim në mënyrë më efektive dhe më kualitative tu përgjigjet nevojave të tyre, si dhe të sigurojë partneritet në ndërtimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore lokale.

Ky qëllim do të arrihet përmes:

- 1) Informimit të qytetarëve nga ana e komunës për mundësinë për shoqërim, për bashkëpunim, për përfitimet nga shoqërimi etj.;
- 2) Mbështetje gjatë formimit të organizatave qytetare (institucionale, juridike, financiare etj.).

Komuna e Jegunovcit do të ndërmerr më shumë aktivitete që ta nxisë zhvillimin e organizatave qytetare në territorin e vet. Për këtë qëllim do të organizohen ngjarje informative për informimin e qytetarëve nga përfitimet nga veprimi i organizuar, për të drejtat themelore të shoqërimit të lirë dhe shprehjen e lirë, për trendët në vend dhe më gjerë, për praktikën më të mira evropiane, rajonale dhe të vendit etj. Do të bëhet përpjekje që ngjarjet informative të organizohen në të gjitha vendbanimet e komunës, ndërsa me këtë të nxitet shoqërimi qytetar në ato.

Si plotësim i kësaj, komuna do të ofrojë ndihmë juridike pa pagesë për grupet e qytetarëve të cilët do të vendosin të themelojnë shoqata ose forma tjera të shoqërimit. Organizatat do të kenë qasje deri te informatat themelore për themelimin e organizatës, duke përfshirë edhe përgatitjen e dokumenteve themeluese dhe këshilla për gjithë procesin. Mjete themelore të nevojshme për organizatat e porsaformuara do të sigurohen nga komuna.

## 3.3. Inkuadrimi aktiv i qytetarëve dhe organizatave qytetare në proceset e krijimit të politikave lokale

Qëllimi është t'u mundësohet organizatave qytetare t'i prezantojnë qëndrimet e veta lidhur me politikat lokale dhe të njëjtat të merren parasysh në proceset e vendimmarrjes. Krahas formave ekzistuese ligjore për konsultim të qytetarëve nga ana e pushtetit lokal, në bashkëpunim me sektorin civil do të krijohen edhe forma tjera të bashkëpunimit të cilët do të bashkëveprojnë ndaj nevojave dhe mundësive të bashkësisë. Ky qëllim do të arrihet përmes:

- 1) Vendosjes së masave për pjesëmarrje të organizatave qytetare në procesin e planifikimit dhe përgatitjes së dokumenteve strategjike të komunës;
- 2) Inkuadrimi i rregullt i organizatave qytetare dhe qytetarëve në proceset e përgatitjes së dokumenteve strategjike; dhe
- 3) Inkuadrimi i përfaqësuesve të organizatave qytetare në punën e komisioneve të komunës.

Pjesëmarrja e organizatave qytetare në përgatitjen e dokumenteve strategjike të komunës (në fusha të ndryshme), do të sigurohet përmes përcaktimit të kriterëve dhe procedurës për zgjedhje të përfaqësuesve në grupet punuese dhe/ose komisioneve të cilat i përgatisin dokumentet strategjike. Për këtë qëllim do të formohet grup i përzier punuese i përbërë nga përfaqësuesit e administratës komunale dhe organizatat qytetare, të cilat do t'i propozojnë kriteret dhe procedurën për zgjedhje. Krahas përpjekjeve për inkuadrim të drejtpërdrejtë të organizatave në grupet punuese, për qytetarët e interesuar dhe organizatat tjera për politikë ose strategji konkrete, e cila përgatitet, do të organizohen ngjarje të hapura konsultative (tribune publike etj.). Në mënyrë plotësuese, në ueb faqen e komunës do të publikohen të gjitha propozim dokumentet dhe për të njëjtat do të sigurohet afat adekuat kohor, ku qytetarët dhe organizatat e interesuara do të mund ti japin vërejtjet dhe propozimet e veta. Për pjesëmarrje të rritur të organizatave qytetare, komuna përmes kriterëve dhe procedurave të vendosura për inkuadrim të sektorit civil në krijimin e politikave lokale varësisht nga temat të cilat diskutohen, do të sigurojë inkuadrim të përfaqësuesve të organizatave qytetare në proceset e përgatitjes së dokumenteve strategjike, si dhe në komisionet e përhershme të Këshillit.

## 3.4. Kontribut drejt qëndrueshmërisë financiare të sektorit civil dhe vendosja e partneriteteve mes organizatave dhe komunës

Krahas iniciativave të komunës për nxitjen e veprimit të organizuar të qytetarëve për interesa të ndryshme dhe themelimi i organizatave të reja (qëllimi 1), me këtë qëllim do të ndërmerren masa për qëndrueshmëri financiare të organizatave qytetare. Qëndrueshmëria do të mbështetet në mënyra të ndryshme (financimi i drejtpërdrejt ose përmes ko-financimit dhe shërbimeve të serviseve). Qëndrueshmëria financiare e sektorit civil në masë të madhe varet edhe nga realizimi i projekteve të përbashkëta ose projekte të iniciuara dhe të financuara nga ana e komunës ose donatorëve të vendit dhe të jashtëm. Për shkak të punës më efikase dhe më ekonomike, komuna do të angazhohet drejt delegimit të kompetencave të caktuara të veta, të cilat në emër dhe për llogari të komunës do të kryejnë organizatat qytetare.

Ky qëllim do të arrihet përmes:

- 1) Formimi i fondit për mbështetje të sektorit civil në kuadër të buxhetit vjetor të komunës;
- 2) Vendosja e kriterëve transparente dhe procedurës për financimin e organizatave qytetare;
- 3) Përcaktimi i pikës informative për mbështetje të punës së organizatave qytetare dhe vetë qytetarëve;
- 4) Krijimi i kushteve për delegimin e kompetencave nga komuna te organizatat qytetare; dhe
- 5) Mbështetja e ndërsjellë e komunës dhe organizatave qytetare në aplikimin e përbashkët të BE dhe projekte tjera ndërkombëtare.

Në kuadër të buxhetit të komunës do të përcaktohet lartësia e mjeteve të dedikuara për financimin e projekteve në bashkëpunim me sektorin civil, në mënyrë adekuate ndaj nevojave reale, por edhe mundësitë e komunës, si dhe fond i veçantë nga buxheti i dedikuar për ko-financimin e projekteve. Grup i veçantë punues do të zhvillojë kriterë dhe procedura transparente për financim të organizatave drejtpërdrejt nga komuna dhe për ko-financimin e projekteve të mbështetura nga donatorë të tjerë, ndërsa të zbatuara nga organizatat qytetare. Për këtë qëllim komuna çdo vit nga buxheti do të veçojë shumë të caktuar, e cila do të jetë e kapshme gjatë gjithë vitit kalendarik, me qëllim që të gjitha organizatat të cilat kanë fituar mbështetje për projektet e tyre nga burime

tjera, nga komuna të mund të fitojnë mjetet për pjesën tjetër të mbetur për kryerjen e aktiviteteve projektuese. Do të përgatiten edhe formularë për aplikimin e standardizuar dhe për financimin dhe për ko-financimin e projekteve nga ana e komunës.

Do të sigurohet edhe mbështetje teknike-materiale për hapësirë (si info qendër) në ndërtesën e pushtetit lokal dhe do të dedikohet për mbledhje/trajnime, punë aktuale etj., për organizatat qytetare, ndërsa edhe informim të qytetarëve dhe organizatave qytetare për mundësitë për huazimin e zyrave për nevojat e tyre.

Përmes analizës do të caktohen fushat ku komuna do të mund t'u delegojë kompetenca organizatave qytetare. Në periudhën e zbatimit të kësaj strategjie do të bëhen përpjekje të vendoset dhe të aplikohet kompetencë të paktën në një fushë.

## 3.5. Përmirësimi i kapaciteteve të administratës komunale dhe organizatave qytetare

Paralelisht me aktivitetet për promovimin dhe zhvillimin e sektorit civil do të qaset edhe ndaj përgatitjes së analizës së nevojave për forcimin e kapaciteteve të administratës komunale dhe të organizatave qytetare. Forcimi i kapaciteteve do të kontribuojë drejt kuptimit më të mirë të aktiviteteve dhe të organizatave qytetare dhe të komunës që shkon drejt sigurimit të kushteve themelore për vendosje.

Ky qëllim do të arrihet përmes:

- 1) Analizimi i nevojave për forcimin e kapaciteteve të administratës komunale dhe të organizatave qytetare;
- 2) Zbatimi i planit për forcimin e kapaciteteve; dhe
- 3) Informimi i vazhdueshëm i ndërsjellë për mbindërtimin e bashkëpunimit.

Rezultatet e lartpërmendura do të arrihen përmes vlerësimit të nevojave për forcimin e kapaciteteve të administratës komunale për mirëkuptim dhe bashkëpunim të sektorit civil, si dhe vlerësimi i nevojave të organizatave qytetare për nxitjen e aktivizmit qytetar dhe inkuadrim më të madh të opinionit në sektorin civil. Në bazë të vlerësimit, do të përgatitet plan me aktivitete për trajnim, konsultime, vizita studimi, informata etj. dhe për administratën komunale dhe për organizatat qytetare. Vëmendje e veçantë do ti kushtohet organizimit të ngjarjeve të përbashkëta edukative në të cilat do të marrin pjesë edhe organizatat qytetare dhe përfaqësues nga komuna (nga administrata dhe nga Këshilli). Informatat për aktivitetet dhe ngjarjet e planifikuara të dy palëve do të ndahen në kohë, si dhe pjesëmarrje e rregullt e aktiviteteve nga ana e të dy palëve do të praktikohet.



# IV. ZBATIMI, PËRCJELLJA DHE REVIZIONI

Komuna dhe organizatat qytetare që do ta përcjellin zbatimin e Strategjisë, si dhe efektivitetin e saj, me qëllim që ta përshtatin me nevojat momentale. Komuna dhe organizatat qytetare do të përgatisin plan për përcjelljen e zbatimit të Strategjisë.

Personi përgjegjës për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe departamenti nga i cili është pjesë personi përgjegjës do të jetë përgjegjës primar për zbatimin e planit aksionar. Zbatimi i Strategjisë do të përcillet përmes përgatitjes së raporteve vjetore nga ana e personit përgjegjës/departamentit, që në muajin e fundit të vitit do ta dorëzojë raportin për miratim deri te Këshilli i Komunës. Raporti do të japë informata për arritjet e indikatorëve të përcaktuar në planin aksionar të Strategjisë, si edhe rekomandime për realizimin e tyre të mëtejshëm.

Pas vitit të tretë nga zbatimi i Strategjisë personi përgjegjës dhe departamenti në konsultime me përfaqësuesit e organizatave qytetare, nëpunësit tjerë relevant në komunë dhe përfaqësuesit e Këshillit do të përgatisin plan për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë. Vlerësimi do të përgatitet nga ana e ekspertëve të pavarur. Rezultatet nga vlerësimi do të përmbajnë analizë për zbatimin, informata për qëllimet e arritura dhe rekomandime për ndryshimin dhe përshtatjen e Strategjisë dhe të Planit aksionar ndaj gjendjeve dhe nevojave.

Komuna e Jegunovcit dhe personi konkret përgjegjës për bashkëpunim do ta kenë rolin primar në koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë. Të njëjtit janë kompetent për vlerësimin vjetor dhe raportimin për mënyrën e zbatimit të Strategjisë.

Aktivitetet konkrete për zbatimin e Strategjisë me kornizën e përcaktuar kohore, bartësit e aktivitetëve, gjegjësisht institucionet përgjegjëse, indikatorët për aktivitetet e realizuara dhe lokacioni i burimeve të financimit të aktivitetëve janë përmbytur në Planin aksionar i cili është pjesë përbërëse e kësaj strategjie (Shtojca 1).

# Shtojca 1. Plani aksionar



QS 1 Vendosja e mekanizmave për bashkëpunim dhe sigurimi i informimit transparent mes komunës dhe organizatave qytetare						
N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjetet financiare
1.1	Është caktuar personi për bashkëpunim me sektorin civil me kompetenca të qarta të definuara për punë	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Përcaktimi i përkohshëm të kompetencave të personit përgjegjës për bashkëpunim me OQ;</li> <li>► Vendosja e rregullave të informimit dhe komunikimit mes personit përgjegjës dhe organizatave (mbledhje të rregullta, përgatitja e informatave, buletinet, shkëmbimi i informatave etj.).</li> </ul>	VL	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Personi i caktuar për bashkëpunim me OQ</li> <li>► Numri i mbledhjeve të mbajtura mes OQ dhe personit të angazhuar për bashkëpunim</li> <li>► Numri i informatave të dërguara deri te OQ (e-mail)</li> </ul>	Buxheti i VL
1.2	Rregullisht mbahen mbledhjet konsultative (koordinuese) mes komunës dhe sektorit civil	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Mbajtja e takimeve të rregullta me kryetarin e komunës dhe Këshillin (së paku dy herë në vjet) dhe me shërbimet e komunës (mbledhje ad hoc);</li> <li>► Është vendosur mekanizmi për komunikim horizontal të personit përgjegjës për bashkëpunim me nëpunësit tjerë në komunë.</li> </ul>	VL	2012/ në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Numri i takimeve të mbajtura me kryetarin e komunës dhe Këshillin</li> <li>► Numri i pjesëmarrësve në takime</li> </ul>	Buxheti i VL
1.3	Është caktuar pjesë e veçantë në ueb faqe për informimin e sektorit civil	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Riorganizimi i ueb faqes së Komunës së Jegu-novcit;</li> <li>► Informimi i organizimit për mundësitë që i ofron ueb faqja e komunës;</li> <li>► Dorëzimi i rregullt i informatave nga ana e OQ (raportet vjetore për punë, raportimi për aktivitetet, rezultatet, ndikimi etj.);</li> <li>► Shpallja e rregullt (joselektive) e informatave në ueb faqe.</li> </ul>	VL	2012/ në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Ueb faqja e adaptuar</li> <li>► Numri i informatave të shpallura nga OQ në ueb faqen e komunës</li> </ul>	Buxheti i VL / Donatore

N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjetet financiare
1.4	Është vendosur bazë gjithëpërfshirëse e të dhënave të organizatave qytetare në komunë	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Sigurimi i të dhënave nga RQM për organizatat e regjistruara në komunë;</li> <li>▶ Thirrje për regjistrimin në bazën e të dhënave të komunës deri te OQ të regjistruara në komunë;</li> <li>▶ Zgjidhja softuere për bazën e të dhënave;</li> <li>▶ Verndosja e bazës të dhënave në ueb faqen e komunës;</li> <li>▶ Azhurmimi i rregullt i të dhënave.</li> </ul>	VL	2012/ në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Baza e të dhënave e përgatitur</li> <li>▶ Numri i organizatave të regjistruara në bazë</li> </ul>	Buxheti i VL / Donatorë
1.5	Është mbështetur formimi i Forumit të organizatave qytetare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Sigurimi i mbështetjes logjistike për mbledhjet e këshillit iniciues për Forumin;</li> <li>▶ Sigurimi i mbështetjes gjatë vendosjes së dokumenteve themelore të Forumit;</li> <li>▶ Sigurimi i procesit konsultativ për kompetencat dhe rolin e Forumit;</li> <li>▶ Mbështetje e funksionimit të Forumit (hapësirë, logjistikë etj.).</li> </ul>	OQ VL	2012/ në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Hapësira e siguruar për punën e Forumit</li> <li>▶ Dokumentet e miratuara për formimin e Forumit (statuti, memorandum për bashkëpunim të OQ)</li> <li>▶ Numri i organizatave të inkuadruara në forum</li> <li>▶ Numri i mbledhjeve të mbajtura të Forumit</li> </ul>	Buxheti i VL / Donatorë
<b>Q5 2 Krijimi i rrethitës mundësuese për nxitjen dhe zhvillimin e shoqërisë civile në Komunën e Jegunovciç</b>						
N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjetet financiare
2.1	Qytetarët janë informuar për mundësinë për shoqërim, bashkëpunim, përfitimet nga shoqërimi etj.	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Ngjarje promovuese për mundësinë dhe përfitimet nga shoqërimi i qytetarëve dhe bashkëpunimi i tyre me aktiv me OQ;</li> <li>▶ Ngjarje për nxitjen e formimit të minimum një organizate të qytetarëve në çdo vendbanim.</li> </ul>	VL	2012/ në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Numri i ngjarjeve të mbajtura për promovimin e shoqërim;</li> <li>▶ Numri i pjesëmarrësve në ngjarje</li> <li>▶ Numri i organizatave të porsaformuara në vendbanimet</li> </ul>	Buxheti i VL / Donatorë

N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjetet financiare
2.2	Është mbështetur formimi i organizatave qytetare (institucionale, juridike, financiare).	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njihma juridike pa pagesë për procesin e regjistrimit të OQ (përgatitja e statutit dhe dokumente tjera themeluese);</li> <li>Përcaktimi i mjeteve nga buxheti i komunës për mbështetjen e regjistrimit të OQ të reja.</li> </ul>	VL	2013/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i konsultimeve me themeluesit potencial të OQ të reja</li> <li>Numri i organizatave të porsafornuara të cilat e kanë shfrytëzuar mbështetjen nga komuna</li> </ul>	Buxheti i VL
<b>Q3 3 Inkuadrimi aktiv i qytetarëve dhe organizatave qytetare në proceset e krijimit të politikave lokale</b>						
N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjetet financiare
3.1	Janë përgatitur masat për sigurimin e pjesëmarrjes së organizatave qytetare në procesin e planifikimit dhe përgatitjes së dokumenteve strategjike	<ul style="list-style-type: none"> <li>Formimi i grupit punues të përzier për përgatitjen e procedurës dhe kritereve për zgjedhje të përfaqësuesve të OQ;</li> <li>Vendosja e sistemit (procedurës dhe kritereve) për zgjedhje të përfaqësuesve të OQ në grupet punuese për përgatitjen e dokumenteve strategjike.</li> </ul>	VL	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rregullorja e përgatitur për inkuadrim të OQ në proceset e krijimit të politikave lokale</li> <li>Rregullorja e përgatitur (me procedurë dhe kritere) për zgjedhje të OQ në grupet punuese për përgatitjen e dokumenteve strategjike</li> </ul>	Buxheti i VL
3.2	Organizatave qytetare dhe qytetarët rregullisht inkuadrohen në proceset e përgatitjes së dokumenteve strategjike	<ul style="list-style-type: none"> <li>Organizimi i tribunave publike me qytetarët/OQ të interesuara gjatë krijimit të strategjive dhe programeve;</li> <li>Publikimi i propozim strategjive dhe akteve tjera në ueb faqen e komunës me mundësinë për dorëzimin e komenteve të qytetarëve/OQ.</li> </ul>	VL	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i tribunave të organizuara publike</li> <li>Numri i pjesëmarrësve në tribuna publike</li> <li>Numri i propozim dokumenteve strategjike të shpallura në ueb faqen e komunës</li> </ul>	Buxheti i VL / Donatorë

N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjetet financiare
3.3	Përfaqësues të organizatave qytetare Inkuadrohen në punën e komisioneve të komunës	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Vendosja e sistemit (procedurë dhe kritere) për seleksionimin e përfaqësuesve të OQ</li> <li>► Inkuadrimi i përfaqësuesit nga ana e OQ në pajtim me temën për diskutim të komisioneve</li> </ul>	VL	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Rregullorja e përgatitur për inkuadrin të përfaqësuesi të OQ në punën e komisioneve të komunës</li> <li>► Numri i komisioneve ku janë inkuadruar përfaqësues të OQ</li> <li>► Numri i mbledhjeve të komisioneve ku marrin pjesë përfaqësues të OQ</li> <li>► Numri i propozimeve të pranuar nga përfaqësuesit e OQ</li> </ul>	Buxheti i VL
<b>Q5.4 Kontribut drejt mbështetjes financiare të sektorit civil dhe vendosja e partneritete mes OQ dhe komunës</b>						
N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjetet financiare
4.1	Është themeluar fondi për mbështetje të sektorit civil në kuadër të buxhetit vjetor të komunës	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Përcaktimi i lartësisë së mjeteve (përqindja) në buxhetin e komunës për mbështetje të projekteve të OQ.</li> </ul>	VL Komisioni për financa dhe buxhet –Këshilli i komunës	2013/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Përqindja e buxhetit të komunës i cili është përcaktuar për mbështetjen e projekteve të OQ</li> <li>► Vendimi i miratuar i Këshillit të komunës për mbështetje financiare të OQ</li> </ul>	Buxheti i VL
4.2	Janë vendosur kritere transparente dhe procedurë për financimin e organizatave qytetare	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Formimi i grupit punues për zhvillimin e kritereve transparente dhe procedurës për financim dhe ko-financim të projekteve të OQ;</li> <li>► Përgatitja e kritereve dhe procedurës për financim në mënyrë participative;</li> <li>► Përgatitja e formularëve për aplikim;</li> <li>► Shpallja e rregullt e thirrjes publike.</li> </ul>	VL OQ	2012/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Krite dhe procedura të zhvilluara për financim dhe ko-financim e projekteve të OQ</li> <li>► Formularë të përgatitur për aplikim</li> <li>► Raporte nga thirrjet publike të shpallura (ku është publikuar thirrja, afati nga shpallja deri te afati për aplikim, numri i paraqitjeve etj.)</li> </ul>	Buxheti i VL

N. r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjetet financiare
4.3	<p>Është përcaktuar pika informative për mbështetje të punës së organizatave qytetare dhe vetë qytetarëve</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Përcaktimi dhe aftësimi teknik i ambientit në ndërtimin e komunës (për mbledhje/trajtime, punën aktuale etj. për organizatat qytetare);</li> <li>▶ Informimi i organizatave për mundësitë e kapshme në ambientin e caktuar (info pika).</li> </ul>	VL OQ	2013/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Ambienti i caktuar dhe i pajisur në ndërtimin e pushtetit lokal për mbështetje të OQ</li> <li>▶ Informata e shpallur për mundësitë e reja</li> <li>▶ Numri i ngjarjeve të mbajtur në pikën informuese</li> </ul>	Buxheti i VL / Donatorë
4.4	<p>Janë krijuar kushtet për delegimin e kompetencave nga komuna në organizatat qytetare</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Analiza e fushave specifike me interes për vendosjen e partmentitit me OQ përmes delegimit të kompetencave;</li> <li>▶ Zhvillimi i kriterëve për delegimin e kompetencave;</li> <li>▶ Vendosja e praktikës për delegimin e kompetencave.</li> </ul>	VL	2013/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Fushat e defnuara specifike për të cilat mund të delegohen kompetenca të komunës</li> <li>▶ Krite të miratuara për delegimin e kompetencave</li> <li>▶ Numri i organizatave mbi të cilat janë deleguar kompetenca</li> <li>▶ Numri i kompetencave të deleguara</li> </ul>	Buxheti i VL
4.5	<p>Komuna dhe organizatat qytetare mbështeten në aplikimin e përbashkët në projekte të BE dhe projekte tjera ndërkombëtare</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Përcaktimi i fondit të veçantë nga buxheti i dedikuar për ko-financimin e projekteve</li> </ul>	VL OQ	2013/në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Shuma (%) e mjeteve në buxhetin komunal të dedikuar për ko-financimin e projekteve</li> <li>▶ Numri i organizatave të mbështetura me ko-financim</li> </ul>	Buxheti i VL

QS 5 Përmirësimi i kapaciteteve të administratës komunale dhe të OQ						
N.r.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Korniza kohore	Indikatorët	Mjetet financiare
5.1	Janë analizuar nevojat për forcimin e kapacitetit të administratës komunale dhe të organizatave qytetare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Zbatimi i anketës për vlerësim të nevojave;</li> <li>▶ Përgatitja e raportit dhe planit për forcim të kapaciteteve.</li> </ul>	VL	2012/ në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Raport nga anketa;</li> <li>▶ Plani i përgatitur për forcimin e kapaciteteve të administratës</li> </ul>	Buxheti i VL
5.2	Zbatohet plani për forcimin e kapaciteteve	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Organizimi i trajnimit për forcimin e kapaciteteve për administratën komunale dhe anëtarëve të kështillit;</li> <li>▶ Pjesëmarrja e përbashkët në trajnime të organizatave qytetare dhe përfaqësuesve të komunës;</li> <li>▶ Pjesëmarrja e përbashkët në vizita studimi.</li> </ul>	VL OQ	2012/ në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Numri i trajnimeve të organizuara</li> <li>▶ Numri i pjesëmarrësve në trajnim</li> <li>▶ Numri i vizitave të studimit ku kanë marrë pjesë përfaqësuesit e komunës dhe OQ</li> </ul>	Buxheti i VL / Donatorë / OQ
5.3	Informimi i vazhdueshëm i ndërsjellë për mbindërtimin e bashkëpunimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Ndërrja e informatave /materialeve me rëndësi për bashkëpunimin e ndërsjellë.</li> </ul>	VL OQ	2012/ në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Numri i informatave të ndërrja nga ana e komunës</li> <li>▶ Numri i informatave të ndërrja nga ana e OQ</li> </ul>	Buxheti i VL /OQ



